

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
67	4.11.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: kërkese për informacion dhe vënie ne dispozicion te dokumentacioni shtetëror "mbi praktika e miratimeve mjedisore te ndjekura nga institucionet tuaja per ndërtimin te HEC Kasollet e Salcës, me zhvillues subjektin *****	14.11.2024	Kthyer përgjigje me shkresë zyrtare nga AKM	Përfunduar	0
68.	7.11.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: 1- A planifikohet përmirësimi i sistemit të monitorimit të ajrit dhe nëse po, cilat janë detajet e planit? Sa stacione monitorimi parashikohet të shtohen dhe në cilët qytete? 2- Sa është buxheti në dispozicion për këtë qëllim? 3- Cilat janë investimet e bëra në periudhën 2014-2024 në drejtim të sistemit		Në proces		

		të monitorimit të ndotjes së ajrit? 4- Përse shërbimi për riparimi dhe rivënien në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit, në vitin 2022 është marrë në dorëzim vetëm në bazë të deklarimeve të operatorit ekonomik që ka zbatuar kontratën? 5- Përse ministria ka ndjekur praktikën e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike në drejtim të 7 stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit?				
69.	14.11.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1 - Sa është numri i bujtinave dhe hoteleve në zonën e Lurës (Peshkopi/Dibër), të licencuara nga Ministria e Turizmit? 2- Sa të ardhura ka gjeneruar buxheti i shtetit nga taksimi i bujtinave dhe hoteleve në zonën e Lurës?	21.11.2024	Ju bëjmë me dije se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në përfundim të procesit të aplikimit për kategorizimin, përditëson të dhënat për subjektet e kategorizuara, duke administruar edhe të dhënat për vendndodhjen e objektit të kategorizuar dhe grupuar në nivel Bashkie. Lista e përditësuar në lidhje me certifikimin e veprimtarive turistike gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në linkun: https://turizmi.gov.al/licensa-certifikata-leje/ .	Përfunduar	0

		<p>3- Sa është numri I bujtinave dhe hoteleve në fshatin Perlat (Mirditë), të licencuara nga Ministria e Turizmit?</p> <p>4- Sa të ardhura ka gjeneruar buxheti i shtetit nga taksimi i bujtinave dhe hoteleve në fshatin Perlat?</p>		<p>Ne lidhje me subjektet e kategorizuara (bujtina dhe hotele) ne Bashkinë Peshkopi, lutem gjeni bashkëlidhur listën e plote.</p> <p>Sa i përket nivelit të ardhurave publike nga taksimi I aktiviteti privat ne këto fshatra, bëjmë me dije se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nuk administron asnjë të dhënë të tilla, pasi tatimet, taksat, të ardhurat fiskale, janë jashtë fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.</p>		
70.	14.11.2024	<p>Kërkese për informacion ne lidhje me: A ka kërkuar *** ** leje te ju për eksport të mbetjeve apo kalim transit të mbetjeve gjatë periudhës 2022-2024? Nëse po kur konkretisht e ka kërkuar këtë leje?</p> <p>Nëse ka marr leje për eksport të mbetjeve gjatë periudhës 2022-2024, lutem na vini ne dispozicion një kopje të kësaj leje.</p>	19.11.2024	<p>Për periudhën 2022-2024 nuk është paraqitur asnjë kërkesë dhe për rrjedhojë nuk është lëshuar asnjë autorizim për subjektin *****.</p>	Përfunduar	0
71.	14.11.2024	<p>Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtare</p>		<p>Në proces</p>		

72.	22.11.2024	<p>Kërkesë për informacion ne lidhje me: Më konkretisht, ***** ka kërkuar më 25 korrik 2024 autorizimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit për të eksportuar drejt ***** 8 mijë ton mbetje të rrezikshme për riciklim, por kërkesa është refuzuar. Kërkesa është përsëritur dhe pritet një vendimmarrje.</p> <p>Lidhur me faktet e mësipërme, ne kërkojmë të dhënat si më poshtë:</p> <p>1-Arshet e refuzimit të kërkesës për eksportin e mbetjeve të rrezikshme, së bashku me një kopje të përgjigjes që Ministria e Mjedisit i ka kthyer kompanisë *****</p> <p>2- Raporte inspektimi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së</p>	4.12.2024	<p>Referuar kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se subjekti “*****” ka depozituar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kërkesën për pajisjen me Autorizim për eksportin e mbetjeve të rrezikshme, të llojit mbetje pluhur nga furra elektrike me hark (PPEH) me përmbajtje oksid zinku, sipas katalogut të mbetjeve 10 02 07*, për një sasi prej 8,000 ton.</p> <p>Saktësojmë se kërkesa nuk është refuzuar, por pas shqyrtimit të aplikimit kanë rezultuar mangësi në dokumentacion. Pas plotësimit të dokumentacionit nga ana e subjektit, aplikimi është në proces shqyrtimi. Bazuar në VKM 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte”, të ndryshuar, Ministria përgjegjëse për mjedisin njofton në rrugë zyrtare autoritetin kompetent të destinacionit dhe autoritetin/et kompetent/e të transitit në momentin e marrjes së kërkesës për eksport të mbetjeve. Ministri jep autorizimin për eksport të mbetjeve të rrezikshme për qëllim asgjësimi ose rikuperimi dhe të mbetjeve jo të rrezikshme që destinohen për qëllim asgjësimi, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim nga autoriteti/et kompetent/e i destinacionit dhe/ose i transitit.</p> <p>Përsa i takon raporteve të inspektimit mbi sasinë e mbetjeve për të cilat subjekti kërkon Autorizim për eksport, nga procesverifikimi i kryer, është konstatuar se në një ambjent të aktivitetit, të mbrojtur nga agjentët atmosferik (zone e mbuluar, shtuar me shtresë betoni dhe e rrethuar) janë depozituar një pjesë e këtyre mbetjeve të sistemuara në thasë bigbags, ndërsa sasinë e plotë prej 8,000 ton subjekti parashikon ta gjenerojë gjatë gjithë vitit kalendarit kur punohet me kapacitet të plotë.</p>	Përfunduar	0
-----	------------	--	-----------	---	------------	---

		<p>Turizmit dhe Mjedisit mbi kushtet e magazinimit, ruajtjes apo problematika të mundshme të sasisë së mësipërme të mbetjeve të rrezikshme nga ana e kompanisë *****</p> <p>3- Vendime të AKM apo MTM për masa administrative të ndërmarra ndaj kompanisë ***** gjatë viteve 2023-2024 në lidhje me mënyrën e magazinimit apo trajtimit të mbetjeve të rrezikshme.</p> <p>4- Në çfarë faze është shqyrtimi i kërkesës së re të bërë nga ***** për eksportimin drejt ***** të sasisë prej 8 mijë ton mbetje të rrezikshme? A ka bërë Ministria verifikime për kapacitetet ricikluese të vendit pritës dhe çfarë e ka penguar deri më tani eksportimin e këtyre mbetjeve?</p>		<p>Në lidhje me masat administrative të ndërmarra ndaj subjektit “*****.a gjatë viteve 2023-2024, ju informojmë se subjekti është inspektuar 2 herë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.</p> <ul style="list-style-type: none"> · Në inspektimin e vitit 2023, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndaj subjektit ka vendosur masën administrative “Gjobë”. · Nga inspektimi i kryer në vitin 2024, ku objekti i inspektimit ka qenë zbatimi i kushteve të lejes së mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka vendosur masë administrative “Gjobë” dhe “Pezullim të aktivitetit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme deri në momentin e lidhjes së kontratës/ve përkatëse me një subjekt të licencuar për trajtimin/asgjësimin përfundimtar të tyre.” 		
--	--	---	--	---	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

- (5) Ndiemon kërkesin për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.